



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME mars 2018
BEQ-nr 32/2018



EVROPA JUJAJ - ZGJIDHJA JUJAJ 2018



Sipas të rinjve nga Evropa, mundësitë më të mëdha për mësimin e gjuhëve nëpërmjet udhëtimeve, lokacioneve kulturore evropiane të arritshme dhe ruajtjes së kulturës përmes kuzhinës dhe zejeve nacionale, mund të frymëzojnë evropianët e rinj të zbulojnë kultura të ndryshme dhe të arrijnë mirëkuptim më mirë për trashëgiminë e përbashkët kulturore. Këto rekomandime u propozuan nga 99 studentë nga e gjithë Evropa, të cilët morën pjesë në ngjarjen vjetore të rinisë Evropa Juaj, Fjala Juaj (YEYS) 2018.

Në organizimin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Komitetit Social (EESC), ngjarja u zhvillua në Bruksel për herë të nëntë.

Më 15 dhe 16 mars, Këshilli Evropian Ekonomik dhe Social i përshëndeti studentët nga 33 shkolla të mesme në 28 vende anëtare të BE dhe 5 vende candidate. Meqenëse viti 2018 është Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore, YEYS u përqendrua gjithashtu në kulturën dhe zgjodhi temën E bashkuar në llojlojshmëri: e ardhme më e re për kulturën evropiane.

Zëvendëskryetari i EESC, Gonzalo Lobo Ksavier e theksoi rëndësinë e dëgjimit të të rinjve dhe të merren parasysh idetë e tyre.

Gjatë debateve intensive dhe punëtorive, nxënësit diskutuan se si të ruajnë trashëgiminë kulturore evropiane dhe ta bëjnë atë më tërheqëse për evropianët e rinj. Idetë përfshijnë tema të rëndësishme dhe shumë të diskutuara në Evropë, të tilla si barazia, siguria dhe integrimi, të cilat mund të përmirësohen përmes aktiviteteve kulturore. Nga 10 rekomandimet specifike për politikëbërësit e BE-së, tre propozimet më tërheqëse u zgjodhën me votim:

1. Mundësi për të zbuluar kultura të tjera përmes udhëtimit. Ky projekt sugjeron krijimin e programit të veçantë për shkëmbimin e programeve të studimit me orë për gjuhë, ku nxënësit do të jetojnë në familjet niqoire dhe do të mësojnë rreth kulturave të reja.

2. Ruajtja e kulturës, mësimi nga e kaluara

dhe përdorimi i saj për të ndërtuar një të ardhme. Ky rekomandim synon të krijojë një lloj "Shtëpi të Kuzhinës" të Bashkimit Evropian në secilin Vend Anëtar. "Kur do të porositini një ushqim nacional të caktuar, shërbimi do të përfshijë vërejtje të vogël duke shpjeguar rrethanat historike në të cilat pjata së pari ishte krijuar dhe do të ndërtojë tolerancë më të madhe në mesin e nacionaliteteve", theksoi një prej delegatëve nga Sllovenia. Përveç kësaj, grupi i nxënësve propozoi krijimin e një programi për mbështetje të dyqaneve të vogla, tradicionale, zeytare me qëllim të rruhet kultura jonë tradicionale popullore;

3. Eksperimentoni me kulturën. Ky projekt ka për qëllim t'i afrojë kulturën dhe trashëgiminë kulturore me të gjithë njerëzit duke krijuar festivale për udhëtime dhe duke shmangur përqendrimin e muzeve në qytetet e mëdha.

Adoleshentët evropianë patën mundësinë të diskutonin rëndësinë e ruajtjes dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore me anëtarët e EESC, ekspertët dhe artistët.

Çdo vit, EESC sipas zgjidhjes së rastësishme zgjodhi dhe fton 33 shkolla - që përfaqësojnë Vned Anëtar ose vend kandidat - për të marrë pjesë në këtë Iniciativë të vetme vjetore të të rinjve. Ashtu siç YEYS po bëhet gjithnjë e më popullore, nënkryetari, z. Lobo Ksavier propozoi të krijohet rrjet të nxënësve dhe mësimdhënësve të kaluar dhe të tashëm nga YEYS.

<https://www.eesc.europa.eu>

Përmbajtja e lajmeve:

Evropa Juaj, Zgjidhja Juaj 2018	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2-3
Aktivitetet e Kuvendit të lidhura me Çështjet Evropiane	4-5
Raport vjetor për sistemin për paralajmërim të shpejtë për prodhimet e rrezikshme	6
Erazmus+ me versionin e vet të internetit	7
Sa Ballkani është larg standardeve për aderim drejtë BE-së	8
Propozim masa të reja të politikës tatimore të Komisionit Evropian	9
Qasje falas në internet pa tel në qytete	10
Data e kontraktuar për mbajtjen e zgjedhjeve për PE	10
Dita Ndërkombëtare e Pyjeve 2018	11
BE kalendar / prill 2018	11

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN



<http://www.europarl.europa.eu>

Seanca Plenare 12-15 mars 2018

Në debatin me Andrus Ansip, zëvendëskryetari i Komisionit Evropian, evro deputetët ftuan 11 shtete anëtare të ratifikojnë Konventën e Stambollit. Njëmbëdhjetë vendet anëtare të cilat nuk e kanë ratifikuar ende Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, i njohur si Konventa e Stambollit janë: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Greqia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Sllovakia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Gjatë debatit, shumica e eurodeputetëve shprehu keqardhje për faktin se këto vende (duke përfshirë Bullgarinë, e cila aktualisht kryeson Këshillin e BE-së) nuk e konsiderojnë Konventën për instrument më të mirë në dispozicion kur është fjala për luftimin e dhunës ndaj grave. Eurodeputetët theksuan se mosgatishmëria për të ratifikuar tekstin shpesh bazohet në keqkuptime dhe argumente të rreme për përdorimin e fjalës "gjini" në Konventë. Ata e ftuan Komisionit Evropian dhe Këshillit të marrin masa konkrete për të ndihmuar të gjithë vendet anëtare të ratifikojnë tekstin sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me 488 vota për, 90 kundër dhe 114 të përmbajtur, eurodeputetët miratuan rezolutë për "Efektet negative të krizës ekonomike dhe financiare". Kjo vlen veçanërisht për rajonet me rritje të ulët, të cilat kanë ulur margjinat e politikave buxhetore, të cilat kanë çuar në uljen e investimeve publike. Përveç prioriteteve të financimit të BE-së, këto rajone duhet të përshtasin strategjitë për të mbyllur boshllëqet dhe ofrojnë perspektiva dinamike për popullsinë e tyre.

Eurodeputetët me 604 vota për, 80 kundër dhe 12 të përmbajtur, miratuan rregulla të reja për të përmirësuar dërgimin tejkufitare të pakove, me qëllim të rritjes së blerjeve përmes internetit. Rregullat e reja janë pjesë e paketës e-commerce. Informata më të qarta mbi çmimet për shërbimet për dërgim të pakove duhet të rrisin besimin e konsumatorëve në blerjen dhe dërgimin tejkufitare.

Nga ofruesit e shërbimeve për dërgim të pakove do t'u kërkohet të japin tarifata e tyre për listë paraprakisht të definuar të

shërbimeve të përdorura zakonisht. Komisioni do të publikojë çmimet në veb-sajt të posaçëm për t'u mundësuar konsumatorëve dhe format të krahasojnë tarifata vendore dhe tejkufitare ndërmjet vendeve anëtare dhe ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe të vendosin për marrëveshjen më të mirë. Duke kontribuar në konkurrencë të shëndetshme, rregullorja e re duhet të nxisë zvogëlimin e dallimeve të paarsyeshme midis tarifave. Sipas konsultimeve publike të Komisionit, mbi 2/3 e konsumatorëve hoqën dorë nga blerja onllajn, sepse besojnë se shpenzimet tejkufitare për dërgim janë shumë të larta.

Luis de Gindos mori mbështetjen e Parlamentit për emërimin e zëvendëskryetarit të Bankës Qendrore Evropiane, por eurodeputetët duan të përmirësojnë procesin për nominimet e ardhshme. Pas marrjes së mendimit të pa detyrueshëm nga Parlamenti dhe Këshilli Drejtues i BQE-së, Këshilli Evropian në samitin në Bruksel më 22 mars e shënoi De Gindos si zëvendëskryetarë të BQE-së. Funkionari i ri do të marrë funksionin më 1 qershor të këtij viti me mandat 8-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. Ai do të zëvendësojë zëvendëskryetarin e tanishëm të BQE-së, portugezin Vitor Konstancia.

<http://www.europarl.europa.eu>

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Duke marrë parasysh linjat e kuqe që i publikoi qeveria e Britanisë së Madhe, marrëveshja e asocimit ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe mund të sigurojë kornizë përkatëse për marrëdhëniet e tyre të ardhshme, thuhet në rezolutën e miratuar me 544 vota për, 110 kundër dhe 51 të përmbajtur.

Kjo marrëdhënie mund të bazohet në katër shtylla:

- Marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike (FTA),
- siguria e brendshme,
- bashkëpunimi në politikën e jashtme dhe mbrojtjen, dhe
- bashkëpunimi tematik, si për shembull projektet tejkuftare dhe inovacionet.

Eurodeputetët miratuan emërimin e 45 anëtarëve në "Komitetin Social për Krimin Financiar, evazionin tatimor dhe largimin e tatimeve". Pasi që nuk kishte vërejtje ndaj vendimit për ndarjen e 45 vendeve në komitet, afërsisht në mënyrë proporcionale të përfaqësimit politik në Parlament, vendimi u miratua pa pasur nevojë për votim.

Sipas mandatit të Komitetit, i cili u miratua në seancën e fundit plenare, puna e tij do të përfshijë shqyrtimin e "skemave nacionale për të siguruar privilegje tatimore" mashtrimin me TVSH-në dhe problemet në sigurimin e harmonizimit tatimor në ekonominë digjitale.

Parlamenti Evropian miratoi dy rezoluta mbi shpenzimet dhe të ardhurat nga korniza financiare shumëvjeçare e ardhshme (MFF), të cilat do të zbatohet deri në vitin 2021.

Eurodeputetët besojnë se kufiri aktual i shpenzimeve të BE-së duhet të rritet nga 1% në 1.3% të PBV-së të BE-së, në mënyrë që të mund të financoj këto prioritete të reja pa sakrifikuar rajoneve evropiane dhe bashkësitë bujqësore. Ata gjithashtu paralajmërojnë se "nuk mund të lidhet marrëveshje për MFF pa bërë përparim i duhur në burimet e veta" - dmth. ana e të ardhurave të buxhetit të BE. Shpenzimet dhe të ardhurat duhet të trajtohen si një pako e vetme.

Propozime kyçe përfshijnë rritjen e programeve për hulumtim, Erasmus +, Iniciativën për Punësimin e të Rinjve dhe

Mbështetjen e MSP, si dhe investimet në infrastrukturë përmes Fondit Evropian Lidhës (FEL).

Rezolutat e miratuara janë: Rezoluta e ko investuesve Jan Olbriht (EPP, PL) dhe Izabel Tomas (S & D, FR) për buxhetin afatgjatë të BE-së pas vitit 2020 i cili u miratua me 458 vota pro, 177 kundër dhe 62 të përmbajtur; dhe Rezoluta e ko investuesve Zherard Deprez (ALDE, BE) dhe Janush Levandovski (EPP, PL) për reformë të sistemit të burimeve të veta të BE-së, i cili u miratua me 442 vota pro, 166 kundër dhe 88 të përmbajtur.

Parlamenti Evropian dha mbështetje "Baza e konsoliduar korporative tatimore" (CCCTB) - pjesa e propozimi të gjerë për të krijuar regjim të vetëm, të qartë dhe të drejtë tatimor të BE-së - me 438 vota pro, 145 kundër dhe 69 të përmbajtur.



<http://www.europarl.europa.eu>

<http://www.europarl.europa.eu>

AKTIVITETE TË KUVENDITTË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Talat Xhaferi mbajti fjalimin e tij në Sesionin e parë të punës së Grupit të Punës - 3 të Konventës Nationale për Bashkimin Evropian në Republikën e Maqedonisë i cili u mbajt më 1 mars 2018 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Konventa Nationale për Bashkimin Evropian në Republikën e Maqedonisë paraqet forum të hapur për arritjen e konsensusit më të gjerë shoqëror mbi çështjet që lidhen me aderimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Ajo është model i mobilizimit të publikut profesional për rritjen e kapaciteteve integruese të shoqërisë përmes dialogut mbi tema vitale në frymën e legjislacionit evropian dhe praktikave evropiane.

www.sobranie.mk

Z. Xhaferi shprehu respektin dhe përkrahjen ndaj Lëvizjes Europiane në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë bartës të këtij projekti në Maqedoni, njëherit duke u dëshiruar punë të suksesshme.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Talat Xhaferi, më 9 mars 2018 realizoi takim me ambasadorët e Republikës së Austrisë në Athinë, Podgoricë, Sarajevë, Prishtinë, Beograd dhe Bruksel, të udhëhequr nga Dr. Klaus Vulfer, udhëheqës i seksionit të Ballkanit Perëndimor dhe zgjerimin e BE nga Ministria e Punëve të Jashtme të Austrisë. Në takim morën pjesë edhe ambasadorja e Republikës së Austrisë në Republikën e Maqedonisë, mr. Renate Kobler. Kryetari Xhaferi shprehu kënaqësinë nga takimi në këtë moment më të favorshme për vendin që aspiron të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe të zbatojë vlerat evropiane që janë para së gjithash të rëndësishme për të gjithë qytetarët e saj. Republika e Maqedonisë tejkaloi shumë sfida të vështira në periudhën e kaluar, por vendi ka arritur të kthehet në rrugën e saj evropiane të integritimit dhe të punoj me përkushtim në detyrimet që rrjedhin nga integrimi Euro-Atlantik. Në fushën e ndërtimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, Marrëveshja për miqësi, fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunim me Republikën e Bullgari është ratifikuar në të dy parlamentet, dhe i njëjti ka hyrë në fuqi, dhe ka intensifikuar komunikimin e drejtpërdrejtë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë rreth gjetjes së zgjidhjes për dallimet që Greqia i ka me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë, theksoi z. Xhaferi në pritje të rekomandimit të pakushtëzuar për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE deri në fund të vitit 2018.



Më 23 mars 2018 kryetari i Kuvendit z. Talat Xhaferi realizoi takim me Delegacion nga Grupi i Partisë Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian, të kryesuar nga eurodeputeti Andrey Kovaçev, e udhëhequr nga eurodeputeti Alojz Peterle dhe Tune Kelam. Në takim morën pjesë edhe ambasadori i BE-së në Republikën e Maqedonisë, Samuel Zhbogar. Ai shprehu kënaqësinë nga fakti që në Parlamentin Evropian është përtërirë grup joformal "Miqët e Republikës së Maqedonisë", e cila me ndikimin e saj duhet të kontribuojnë në dukshmëri më të madhe të vendit dhe rrugën e saj drejt BE-së.

Kryetari Xhaferi riafirmoi angazhimet për procesin e reformave në Kuvend në fushat prioritare dhe se përkundër të gjitha sfidave me të cilat përballlet, shumica aktuale është duke punuar në mënyrë aktive për reformat e parapara të Planit të Qeveria "3-6-9", në të cilin janë ndërthurur dhe Rekomandimet e Pribe.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, procedurat për miratimin e tij dhe procedurën e përgjithshme legjislative në pajtim me Rregulloren e Kuvendit dhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, si dhe detajet në lidhje me pakon e reformave në sferën e gjyqësisë, administratën publike dhe reformat në sferën e sigurisë.

AKTIVITETE TË KUVENDITË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe gjithashtu Zëvendëskryetari i Komisionit për Çështje Evropiane, Vesel Memedi dhe kryetari i Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri Hari Llokenec, realizuan takim me Miroslav Jenča, ndihmës sekretari i përgjithshëm për Çështje Politike në Kombet e Bashkuara.

Në këtë takim, Memedi shprehu besimin se Republika e Maqedonisë mbetet në përputhje me qëllimet dhe prioritetet e saj të qëndrueshme dhe të larta, pra anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Ndihmës sekretari i përgjithshëm Jenča tregoi solidaritet dhe mbështetje për përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për tejkalimin e nevojës për të gjetur kompromis për çështjen e emrit, në mënyrë për të zhblokuar procesin dhe vendi të bëhet anëtare në NATO dhe BE. Deputeti Hari Llokenec shprehur gadishmërinë shumica parlamentare të mbështes të gjitha aktivitetet që do të rrisin bashkëpunimin në mes shumicës parlamentare dhe opozitës për të përfunduar procesin e reformave dhe vendi të lëviz në drejtim pozitiv në rrugën drejt aderimit në BE.

Pjesëmarrësit në takim shprehën kënaqësinë me vizitën dhe mundësinë e diskutimit konstruktiv dhe të sigurtë në mënyrë që Republika e Maqedonisë të fillojë negociatat sa më shpejt për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane.



www.sobranie.mk



Komisioni për Çështje Evropiane i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë më 27 mars 2018 mbajti debat publik për Propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediale audio dhe audiovizuale. Fjalime hyrëse për temën patën Kryetari i Komisionit, Artan Grubi, Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski dhe Ministri pa resor, përgjegjës për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, Robert Popovski, ku informuan për rrjedhën e procedurës për miratimin e ndryshimeve të reja ligjore.

Kryetari i Komisionit, z.Grubi, në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale, përshëndeti risitë e paralajmëruara, kur sqaroi se esenca e këtij debati publik është më e thellë dhe ka të bëjë me situatën në mediet në RM, në aspektin e pavarësisë së tyre dhe profesionalizmit, liria e shprehjes në shtet. Për rëndësinë e rregullimit të kësaj sfere, theksoi se flet fakti se gjendja e mediave në vend ishte një nga prioritetet në "Prioritetet urgjente të reformave për Republikën e Maqedonisë", duke iu referuar katër nën-pikave, dhe atë: servisi radiodifuziv publik, reklamat qeveritare, qasja tek informatat dhe çështjen e shpifjes.

Ministri Mançevski tha se ministria kompetente do të marrë parasysh të gjitha propozimet që janë dhënë në debatin publik dhe inicoi të organizohen dhe debate tjera publike për këtë ligj, me qëllim që të arrijë zgjidhje të përshtatshme që do të jenë në interes të informimit publik qytetarëve. Në fund të debatit, Komisioni për Çështje Evropiane miratoi konkluzion me të cilin propozoi që vërejtjet nga debati publik të shqyrtohen në leximin e mëtejshëm të ligjit.

RAPORT VJETOR I SISTEMIT PËR PARALAJMËRIM TË SHPEJTË PËR PRODHIME TË RREZIKSHME



Më 12 mars 2018, Komisioni Evropian publikoi Raport për Sistemin të paralajmërimit të Shpejtë për Produkte të Rrezikshme. Raporti tregon se në vitin 2017, sistemi i paralajmërimit të shpejtë po përdoret gjithnjë e më shumë nga autoritetet nacionale me më shumë se 2,000 paralajmërime për produktet e rrezikshme që qarkullojnë në të gjithë sistemin. Lodra të tilla si disa modele të spinnerëve të popullarizuar, automobilët dhe motoçikleta janë në krye të listës së produkteve të rrezikshme të zbuluara dhe larguara nga tregu.

Komisioneri për drejtësi, konsumatorë dhe barazi gjinore Vera Zhurova theksoi: "Rregullat evropiane për konsumatorët garantojnë që në BE shiten vetëm produktet e sigurt. Sistemi për paralajmërim të shpejtë mbështet autoritetet të reagojnë shpejtë dhe për të hequr çdo produkt që mund të shkaktojë lëndime. Falë këtij sistemi, i mbajmë fëmijët tanë të sigurt dhe parandalojmë aksidentet fatale në rrugët tona. Ky është shembulli i mirë i zbatimit efikas të rregullave të konsumatorëve në BE".

Paralajmërimet 2.201 të dërguara përmes sistemit të paralajmërimit të shpejtë kanë nxitur rreth 4.000 aktivitete të njëpasnjëshme, të tilla si tërheqja e produkteve nga tregu. Kjo tregon se të gjitha autoritetet nacionale kanë ndjekur me kujdes paralajmërimet në sistem dhe kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndihmuar tregun të bëhet më i sigurt për konsumatorët.

Konsumatorët gjithnjë e më shumë blejnë produkte online drejtëpërdrejtë nga vendet e treta. Sfida është të sigurohet që këto produkte të përmbushin standardet e sigurisë të BE.

Shumë nga produktet e rrezikshme të njoftuara nga sistemi i paralajmërimit të shpejtë shiten në platforma online ose tregje. Për të qenë përgjegjës në këtë fenomen, Komisioni Evropian inkurajon bashkëpunimin me kolegët e tyre ndërkombëtarë dhe platforma online për të siguruar që produktet e pasigurta nuk arrijnë konsumatorët në BE. Komisioni dha rekomandim nga 1 mars 2018 për të vendosur masat operative që duhet ti merrin platformat online dhe vendet anëtare për tërheqje të mëtejshme e përmbajtjes ilegale online, duke përfshirë, kur është fjala për produkte të rrezikshme.

Komisioni i fton platformat të ndërmarrin angazhime vullnetare që shkojnë përtej dety-

riveve ligjore të tyre në sferën e sigurisë së produkteve.

Në vitin 2017, lodrat ishin kategoria më e papritur e produktit (29%), e ndjekur nga automjetet motorike (20%) dhe veshmbathjet, tekstilet dhe sende nga sfera e modës (12%). Sa i përket rreziqeve, në vitin 2017, rreziku më i shpesht i paraqitur ishte lëndimi (28%), e ndjekur nga rreziku kimik (22%).

Pjesa më e madhe e produkteve të rrezikshme që janë paraqitur në sistem vijjnë jashtë BE-së. Kina është vendi i origjinës numër një, por numri i paralajmërimeve mbetet i qëndrueshëm në 53% (1,155) në vitin 2017, ashtu si në vitin e kaluar. Komisioni vazhdon të punojë ngushtë me autoritetet kineze, të punojë së bashku dhe të kryejë veprime, siç është shkëmbimi i praktikave të mira. Produktet e rrezikshme me origjinë evropiane marrin pjesë me 413 paralajmërime (26%).

Sistemi i paralajmërimit të shpejtë është mjet i rëndësishëm për zbatimin e ligjeve të BE-së për të drejtat e konsumatorëve nga autoritetet nacionale të konsumatorëve.

Për të përmirësuar më tej zbatimin e saj, Komisioni planifikon të paraqesë në prill "Marrëveshje të re për Konsumatorët" me qëllim të modernizimit të rregullave ekzistuese dhe përmirësimit të mbrojtjes së konsumatorëve. Komisioni do të vazhdojë të punojë në modernizimin e Sistemit të paralajmërimit të shpejtë, duke u mundësuar autoriteteve dhe ndërmarrjeve të mbrojnë më mirë konsumatorët nga produktet e rrezikshme.

Hapi tjetër nga modernizimi i sistemit do të ju mundësojë përdoruesve të lexojnë çdo njoftim në të gjitha gjuhët zyrtare të BE.

ERASMUS + ME VERSIONIN E VET TË INTERNETIT

Erasmus +, një nga programet më të suksesshme të BE-së sot promovon version onlajn. Gjitha aktivitetet do të realizohen si pjesë nga programet për arsim të lartë ose projektet e organizuar për të rinjë. Gjatë fazës së saj përgatitore, Erasmus + Berza Virtuale ka shkaktuar interes në mesin e universiteteve dhe organizatave rinore dhe tashmë janë formuar 50 partneritete, ndërsa 40 personave janë trajnuar si lehtësues për modelimin e debateve.

Kontaktet dhe shkëmbimet me moshatarët nga jashtë janë mundësi e madhe për të fituar njohuri dhe shkathtësi të reja, si dhe për të rritur tolerancën dhe pranimin reciprok. Shkëmbimi virtual e promovon dialogun ndërkulturor mes të rinjve, në përputhje me Deklaratën e Parisit e kontraktuar në takim jozyrtar të ministrave të arsimit të BE në mars 2015. Deklarata ka për qëllim promovimin e qytetarëve dhe vlerave të përbashkëta të lirisë, tolerancës dhe jo diskriminimit përmes arsimit.

Për kohën e pilot-fazës, me buxhet prej 2 milion euro deri në dhjetor të vitit 2018, Erasmus-Virtual Exchange do të arrijë së paku 8.000 të rinj. Nëse është e suksesshme, qëllimi është që të ripërtërihet deri në fund të vitit 2019 dhe të arrijë deri në 17,000 njerëz e më shumë. Në të ardhmen, Erasmus + Virtual Exchange do të mund të bëhet veprim i rregullt dhe të zgjerohet që të arrijë edhe te më shumë të rinj në tjerat rajone.

Nga viti 2015, mbi 1.000 projekte janë financuar ndërmjet universiteteve evropiane dhe jugore të Mesdheut, të cilat planifikojnë të mundësojnë rreth 15,000 studentë dhe punonjës të Mesdheut Jugor për të ardhur në Evropë, ndërsa më shumë se 7,000 evropianë do të studiojnë në ato vende. Rreth 2.200 të rinj nga vendet e BE-së jugore dhe punëtorët e rinj janë përfshirë çdo vit në projektet e të mësuarit joformal.



SA ËSHTË LARG BALLKANI NGA STANDARDET PËR QASJE NË BASHKIMIT EVROPIAN



Sipas Financial Times, Bashkimi Evropian po lëviz drejt nga zgjerimet më të diskutueshme, anëtarësimin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, rajon që është prekur seriozisht nga lufta në vitet 1990 dhe ende vuan nga kontestet e shumta territoriale.

Strategjia e Zgjerimit të BE për Ballkanin Perëndimor në shkurt përcaktoi vitin 2025 si vit regues për hyrjen e Serbi-Malit të Zi në vendet e integritit në BE, por edhe për Maqedoninë, Shqipërinë, Kosovën dhe Bosnje dhe Hercegovinën.

Ky do të jetë zgjerimi më i madh i Bashkimit që nga viti 2004, kur anëtarët e BE u bënë 10 vende ish-komuniste. Shtrohet pyetja - çfarë do të thotë BE dhe sa larg është rajoni nga standardet për aderim në Bashkimin Evropian.

Ballkani Perëndimor ka rreth 18 milionë banorë, më pak se 20 milionë banorë në Rumani, të cilët u bashkuan me BE në 2007, së bashku me Bullgarinë.

Numër i madh i njerëzve emigruan nga Ballkani Perëndimor në vitet 1990 dhe 2000, kryesisht për shkak të luftës dhe varfërisë.

Sipas Bankës Botërore, një në katër banorë të rajonit jetojnë jashtë vendit të tyre të origjinës.

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk janë veçanërisht të mëdha dhe prodhimi i tyre është rreth 1% e bruto prodhimit vendor të BE-së (BPV). Sipas situatës aktuale, pesë nga gjashtë ekonomitë do të renditen në mesin e ekonomive më të vogla evropiane.

Përrjashtim është Serbia, ekonomia më e madhe në rajon, e cila ka BPV më të lartë se disa vende anëtare të BE, siç janë Kroacia dhe Lituania.

Hendeku mes ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE ka ngritur shqetësime, rajoni është vetëm 1/3 e mesatares së Unionit.

Deri në afatin e fundit të Strategjisë së Zgjerimit të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor mbetet shtatë vjet, që do të thotë se ka kohë për të zvogëluar këtë hendek. Rumania dhe Bullgaria, shtatë vjet para se të hyjnë në BE, kanë BPV më të ulët për kokë banori nga Serbia dhe Maqedonia, sot.

Përmirësimi ekonomik me siguri don të thotë qytetarë më të varfër në rajon. Sipas Bankës Botërore, në fillim të viteve 2000, rreth një në tre persona në Ballkanin Perëndimor jetonin me më pak se pesë dollarë në ditë. Situata u përmirësua në vitin 2008, kur ky numër ra në një në pesë banorë.

Pothuajse 70% e mallrave të prodhuara në vendet e Ballkanit Perëndimor eksportohen në BE dhe kjo përqindje është rritur gjatë dekadës

së kaluar. Përfaqësuesi i Lartë i BE për Punë të Jashtme dhe Siguri Federika Mogerini vlerësoi kohët e fundit lidhjet ekonomike si "më të fortët deri tani".

Me ndihmën e investimeve të kompanive evropiane në rajon, u krijuan 240,000 vende pune, që është pothuajse 60% e numrit të përgjithshëm të vendeve të hapura me investime të huaja në rajon.

Ballkani Perëndimor tashmë po merr para nga Bashkimi, i cili ka ndarë miliarda euro për fondet e para-pranimit këtë vit, për më shumë gjatë dhjetë viteve të fundit.

Federika Mogerini theksoi se hyrja e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE nuk është një "çështje përfundimtare", duke shtuar se procesi varet nga zbatimi dhe suksesi i negociatave dhe reformave.

Sipas Komisionit Evropian, një nga përparësitë më të larta në procesin e integritit evropian është forcimi i sundimit të ligjit dhe lufta kundër korrupsionit në rajon.

BE-ja ka thënë se asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk mund aktualisht të konsiderohet si "ekonomi tregu që funksionon", duke vënë në dukje se perspektivat e tyre për anëtarësim në BE kanë ndihmuar për përparim të rëndësishëm.

<https://ec.europa.eu>

MASAT E REJA TË POLITIKËS TATIMORE TË KOMISIONIT EVROPIAN

Komisioni Europian më 21 mars 2018 propozoi masa të reja në politikën e tatimeve në fushën e aktiviteteve digjitale ekonomike në BE. Masat do ta bëjnë Bashkimin udhëheqës global në hartimin e ligjeve tatimore të përshtatshme për ekonominë bashkëkohore dhe moshën digjitale.

Një bum i kohëve të fundit në bizneset digjitale, si kompanitë e mediave sociale dhe ofruesit e përmbajtjeve online, ka kontribuar në rritjen ekonomike në BE.

Regullat aktuale tatimore nuk u hartuan për të kënaqur kompanitë globale, virtualisht ose kanë pak ose aspak praninë fizike.

Ndryshimi është dramatik: 9 nga 20 kompanitë botërore me kapitalizimin e tregut tani janë digjitale, krahasuar me 1 në 20 vjet më parë. Sfida është që të përdoret ky trend, duke siguruar që kompanitë digjitale të kontribuojnë gjithashtu në pjesëmarrjen e tyre të drejtë në taksa.

Nëse kjo nuk sigurohet, ekziston rrezik real për të ardhurat publike të Shteteve Anëtare, meqë kompanitë digjitale aktualisht kanë normë mesatare efektive tatimore prej gjysmës së ekonomisë tradicionale të Bashkimit.

Propozimet e sotme vijnë pasi shtetet anëtare kanë kërkuar zgjidhje të përhershme dhe të qëndrueshme për të siguruar një pjesë të drejtë të të ardhurave tatimore nga aktivitetet online, siç kërkuan udhëheqësit e BE në tetor 2017.

Fitimet që rrjedhin nga aktivitete të tilla si shitja e të dhënave dhe përmbajtja e krijuar nga përdoruesit nuk mbulohen nga rregullat e taksave të sotme. Qasje e koordinuar është e vetmja mënyrë për të siguruar që ekonomia digjitale të tatohet në mënyrë të drejtë, të favorshme dhe në mënyrë që të sigurojë një zhvillim të shëndoshë.

Dy propozimet e ndryshme ligjore të propozuara nga Komisioni do të çojnë në tatimim më të drejtë të aktiviteteve digjitale në BE:

- Nisma e parë ka për qëllim reformimin e rregullave të tatimit mbi të ardhurat në mënyrë që fitimet të mund të regjistrohen dhe taten kur bizneset kanë ndërveprim të rëndësishëm me përdoruesit përmes kanaleve digjitale.

Kjo është zgjidhje afatgjatë e Komisionit.

- Propozimi i dytë është në përgjigje të thirrjeve nga disa shtete anëtare për tatimin e përkohshëm që mbulon aktivitetet e mëdha digjitale që aktualisht i shmangen tatimeve në BE.

Fair
Taxation
for the
Digital
Economy



Kjo paketë përcakton qasje koherente të Bashkimit në sistemin e tatimeve digjitale që mbështet në Tregun e Vetëm Digjital dhe do të llogaritet në negociata ndërkombëtare për të zgjidhur problemin globalisht.

Propozimi i parë - Reforma e Përbashkët e rregullave tatimore të BE-së mbi aktivitetet digjitale do t'i lejojë Shtetet Anëtare të tatimojnë në fitimet e krijuara në territorin e tyre.

Propozimi i dytë - Tatimi i përkohshëm për disa të ardhura nga aktivitetet digjitale siguron që ato aktivitete që aktualisht nuk taten në mënyrë efektive do të fillojnë të gjenerojnë të ardhura direkte për Shtetet Anëtare.

Gjithashtu do të ndihmojë në shmangien e masave të njëanshme për tatimim në aktivitetet digjitale në disa shtete anëtare, të cilat mund të çojnë në shkelje të përgjigjeve kombëtare që do të ishin të dëmshme për tregun tonë të vetëm.

Masat e propozuara do të dorëzohen për miratim në Këshillin dhe Parlamentin Evropian për konsultim.

Bashkimi Evropian do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në diskutimet globale mbi taksat digjitale brenda G20 dhe OECD dhe do të përpiqet për zgjidhje ambicioze ndërkombëtare.

<http://europa.eu/>

QASJE E INTERNETIT FALAS PA TEL NË QYTETE



Qytetet dhe fshatrat në të gjithë BE-në janë ftuar që të regjistrohen për të marrë mjete në para nga Brukseli për të ngritur rrjetin Wi-Fi dhe internet në vende të tilla siç janë parqet, sheshet dhe ndërtesat publike.

Për këtë mundësi, sipas projektit WiFi 1,000 vende do të jenë në gjendje të aplikojnë për 15,000 euro këtë vit.

Qëllimi është të gjithë të marrin falas, internet me shpejtësi të lartë pa tel në të gjithë bllokun.

"Ne nuk jemi këtu për ta dyfishuar shërbimin që ekziston, nuk do të mbulojmë zonë që tashmë është e mbuluar, këtu ka qëllim shumë të qartë - të kemi lidhje në të gjithë Evropën, kështu që kjo lidhje mund të përfitojë nga çdo rajon dhe çdo qytetar", tha Maria Gabriel, Komisionere e BE-së për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale.

Programi kushton 120 milion euro dhe i dedikohet të gjitha Shteteve Anëtare të BE-së për të forcuar lidhjen lokale të lirë dhe jodiskriminuese dhe për të inkurajuar qytetarët që të lidhen me çdo bllok - të gjitha vendet publike

dhe qendrat e tjera të jetës shoqërore.

Çdo vend i përfshirë do të marrë të paktën 15 kupona. Ata do të dorëzohen këtë vit në maj sipas modelit të parë të ardhur, i shërbyer së pari. Përfituesit do të duhet të punojnë pa rrjete reklamuese për të paktën tre vjet.

<http://www.euronews.com>

DATA DAKTORDUAR PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE PËR PARLAMENTIN EUROPIAN



Këshilli dhe pëlqim për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të Parlamentit Evropian më 23-26 maj 2019.

Zgjedhjet në Parlamentin Evropian mbahen çdo pesë vjet. Sipas Kodit Zgjedhor të vitit 1976, zgjedhjet e ardhshme të PE duhet të mbahen nga 6 deri më 9 qershor 2019. Meqenëse vendet anëtare e konsideruan të pamundur mbajtjen e zgjedhjeve në atë kohë, Këshilli njëzëri u pajtua, në përputhje me ligjin zgjedhor, të zgjidhte datat alternative për zgjedhjet.

Pas marrjes së mendimit të Parlamentit, pritet që Këshilli të marrë zyrtarisht vendimin e tij para fundit të qershorit.

Zgjedhjet e fundit të Parlamentit Evropian u mbajtën më 22-25 maj 2014.

Grupet politike evropiane po përgatiten tashmë për zgjedhjet e BE-së, me partitë e mëdha të shqetësuara se, si në votimin e vitit 2014, pjesëmarrja mund të mbetet e ulët,


dhe mbështetja relative mund të rritet për politikanët që janë armiqësor ndaj Bashkimit Evropian.

<http://www.consilium.europa.eu>

Dita Ndërkombëtare e Pyjeve 2018

Dita Ndërkombëtare e Pyjeve kremtohet çdo vit më 21 mars për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve të të gjitha llojeve.

<http://ec.europa.eu>




Pyjet dhe tokat pyjore mbulojnë 182 milion hektarë në BE. Kjo është rreth 42% e sipërfaqes totale të territorit të saj. Në BE ka 0.36 hektarë pyje për kokë banori. Zonat më të mëdha pyjore janë në Suedi (30 milion hektarë), Finlanda (24 m) dhe Spanja (27 m).

Në zonën pyjore si pjesë e sipërfaqes së përgjithshme të vendit, Finlanda (71% e sipërfaqes së tokës) dhe Suedia (67%) janë vendet më pyjore, pasuar nga Sllovenia (64%), Estonia (58%) dhe Letonia %, ndërsa Holanda (8%), Malta (11%) dhe Danimarka (16%) janë vendet më pak të pasura.

Pyjet luajnë rol të rëndësishëm në reduktimin e shkarkimeve të gazrave serrë (GHG). Pyjet e BE thithin 417 milion ton CO2 ekuivalent, që korrespondon me rreth 9% të emetimeve totale të gazrave serrë (4,450 milion ton), krahasuar me më pak se 7% (375 milion ton) në vitin 1990.

Krahasuar me emetimet e gazrave sera në çdo vendë-anëtar, toka pyjore thith më shumë se 80% e ekuivalentit të CO2 në Suedi (84%) dhe mbi 50% në Finlandë (60%), pastaj vijojnë Lituania (44%) dhe Sllovenia (35%).

GHG emissions absorption by forests in the EU (% of GHG emissions absorbed)



KALENDARI I BE / prill 2018

1. Sesioni Plenar i Parlamentit Evropian, 16-19 / 04/2018, Strasburg;
2. Konventa Vjetore mbi Rritjen Gjithëpërfshirëse 2018, 27/04/2018, Bruksel, Belgjikë;
3. Debatë publikë i Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian mbi Strategjinë Plastike të BE-së në Ekonominë Qarkore, 10/04/2018, Bruksel, Belgjikë;
4. Dita digjitale 2018, 04/10/2018, Bruksel, Belgjikë.

European Union
Newsroom

europa.eu
EUROPA > Newsroom > Calendar

Home
Highlights >
Press releases >
Calendar >
Audiovisual
Press contacts
Press facilities >
About the EU >

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

←
April
→

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

QENDRA E KUVENDIT TË BE-së

Adresa: 11 Oktomvri nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokali. 414 dhe 289

Faksi: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ishte zbatuar Projekti IPA "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën janar 2011 - qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte përforcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Në kuadër të projektit IPA, ndihma financiare dhe eksperte u sigurua për krijimin e qendres të BE-së në Parlament.

Qëllimi i themelimit të Qendrës së BE-së është t'i sigurojë deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Asambleenë Parlamentare qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional të Integritimit Europian.

Qendra e BE-së disponon me bibliotekë librash dhe botimesh nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

